

## Veçori të vlerësimit në mësimdhënien e gjuhëve të huaja



### Gjuhësi

**Fjalë kyçe:** vlerësim, instrument vlerësues, kompetencë gjuhësore.

Laureta Vavla

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Shqipëri.

### Abstract

Testimi i gjuhëve të huaja është duke marrë një rëndësi të veçantë në Shqipëri, por si ndjehen mësuesit e gjuhëve të huaja në lidhje me këtë gjë? Si e perceptojnë, planifikojnë dhe e zbatojnë ata vlerësimin in klasat e tyre? A i përdorin ata më pas rezultatet e marra nga vlerësimi i studentëve të tyre? Nëse po, për çfarë? Synimi i këtij studimi është që t'u jepet një përgjigje këtyre pyetjeve bazuar në përgjigjet e dhëna nga vetë mësuesit. Rezultatet e pyetësorit të përdorur tregojnë se mësuesit duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje instrumenteve të vlerësimit dhe të përdorin më mirë informacionin e marrë përmes vlerësimit të kryer.

### Hyrje

Matja dhe vlerësimi i aftësive gjuhësore është një çështje e një rëndësie themelore në përkufizimin e politikave arsimore në përgjithësi, në përcaktimin e shkallës së aftësive gjuhësore në fillim të vitit shkollor dhe ato të arritura nga nxënësit në nivele të ndryshme të edukimit të tyre, në përcaktimin e përparimit të të mësuarit, monitorimin e arritjeve dhe objektivave mësimore, në përgatitjen dhe aktivizimin e "praktikave më të mira" të edukimit gjuhësor, certifikimit etj.

Kjo është një çështje që ndikon në gjithë sistemin arsimor dhe shumë shpesh, debati mbi këtë temë ka qenë veçanërisht intensiv në vitet e fundit në botë ndonëse më pak i tillë në Shqipëri. Ky studim është ndërmarrë pikërisht për të parë më nga afër mënyrën sesi mësuesit e gjuhës angleze perceptojnë dhe më pas zbatojnë vlerësimin në procesin e tyre mësimesor.

### Metodologjia

Për kryerjen e këtij studimi kemi përdorur një pyetësor i cili është i ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë e tij synon të mbledhë informacione të përgjithshme personale dhe profesionale mbi mësuesit e më konkretisht në këtë pjesë u kërkohej informacion mbi gjininë, moshën, kualifikimin më të lartë profesional, vitet e përvojës si mësues etj. Ndërkohë pjesa e dytë përmban pyetje që lidhen drejtpërsëdrejti me çështje të ndryshme të vlerësimit të të nxënimit dhe kryesisht jemi përqendruar në çështje që kanë të bëjnë me planifikimin, zbatimin, rezultatet e tij si dhe rekomandimet e mundshme për përmirësime të mëtejshme të këtij procesi.

Duke qenë se pyetësori është disi i lehtë për t'u menaxhuar dhe plotësuar atëherë vendosëm t'ua shpërndanim atë një numri sa më të madh mësuesish. Kështu, u shpërndanë gjithsej një numër prej 62 pyetësorësh prej të cilëve na u kthyen 54 të plotësuar. Tetë prej mësuesve për një arsye apo një tjetër nuk mundën të dorëzojnë pyetësorët e plotësuar e për pasojë më poshtë do të pasqyrojmë përgjigjet e dhënë prej 54 prej tyre.

### Rezultatet

Pjesa e parë e pyetjeve të pyetësorit na informon se nga 54 mësuesit e gjuhës angleze që plotësuan pyetësorin, 41 janë femra dhe 13 janë meshkuj. Mosha e tyre varion si më poshtë:

Tabela 1.1

Mosha	Numri	%
25 vjeç ose më pak	2	3 %
26-30 vjeç	37	69 %
31-35 vjeç	9	16 %
Mbi 35 vjeç	6	11 %

Pra shohim se mosha e tyre është relativisht e re, më shumë se gjysma e tyre janë në moshën 26-30 vjeç e ndërkohë kjo moshë natyrshëm pasqyrohet dhe në vitet e përvojës së tyre në mësimdhënie e cila gjithashtu varion siç paraqitet dhe në tabelën më poshtë:

Tabela 1.2

Vitet e përvojës në punë	Numri	%
1 vit ose më pak	2	3 %
2-5 vjet	17	31%
6-10 vjet	21	39%
Më shumë se 10 vjet	14	26%

Përsa i takon formimit të tyre kemi këto të dhëna: 3 prej tyre janë doktorantë, 24 kanë kryer studimet pasuniversitare Master Shkencor në Gjuhësi ose Letërsi, 4 kanë kryer studimet Master Profesional në Mësuesi, 23 kanë përfunduar vetëm studimet universitare. Numri mesatar i nxënësve për klasë për këta mësues rezultoi të ishte 36 nxënës.

Pyetjes “Sa herë i vlerësoni nxënësit tuaj gjatë një semestri” një shumicë e konsiderueshme prej 49 prej tyre u përgjigjën dy herë në semestër e ndërkohë vetëm 5 prej tyre u shprehën tre herë në semestër. Nga pyetjet në këtë pjesë të parë të pyetësorit mësuam gjithashtu se rreth 75 % e mësuesve përdornin në përgjithësi instrumente vlerësues të hartuar nga teksti dhe 25 % të mësuesve të mbetur u shprehën se i hartonin më së shumti personalisht këto instrumente megjithatë shpeshherë ata i kombinonin vlerësimet e hartuara vetë me artikujt vlerësues të materialeve të gatshme didaktike.

Në pjesën e dytë të pyetësorit arrijmë të mbledhim informacione më të detajuara dhe të hollësishme në lidhje me procesin e vlerësimit në vetvete. Kështu për fazën e parë atë të planifikimit dhe hartimit të instrumentit vlerësues nga mësuesi mbledhim këto të dhëna:

Tabela 1.3

Planifikimi dhe hartimi i instrumentit vlerësues	Kurrë		Rrallë		Ndonjëherë		Shpesh		Gjithmonë	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në objektivat e lëndës.	-	-	1	2	3	5	28	52	22	41
2. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin kompetencën gramatikore.	-	-	1	2	3	5	11	20	39	72
3. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin kompetencën leksikore.	-	-	-	-	11	20	12	23	31	57
4. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin të lexuarit.	-	-	9	17	28	52	14	26	3	5
5. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin aftësinë e të shkruarit	-	-	-	-	2	3	31	58	21	39
6. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin të dëgjuarit	52	97	2	3	-	-	-	-	-	-
7. Për hartimin e instrumentit vlerësues bazohem në artikujt që masin aftësinë e të folurit.	-	-	15	28	22	41	13	24	4	7
8. Vlefshmëria dhe besueshmëria e artikujve vlerësues që unë hartoj kontrollohet duke u kërkuar komente kolegëve të mi ose duke i referuar udhëzimeve (nëse këto të fundit janë në dispozicion).	51	95	3	5	-	-	-	-	-	-
9. Vlerësimi fokusohet tek përparimi i nxënësve më shumë sesa tek krahasimi mes nxënësve apo klasave.	13	24	5	9	15	28	7	13	14	26
10. I njoftoj nxënësit në kohë në mënyrë që ata të përgatiten për vlerësimin.	-	-	1	2	2	4	49	90	2	4

Shifrat në tabelën e mësipërme flasin për hartimin e instrumenteve vlerësues përgjithësisht të qëllimshëm e të bazuar në objektivat e lëndës. Është një mjaft me interes të shohim ndarjen e përqindjeve të peshës që gramatika, leksiku dhe aftësitë gjuhësore zënë në hartimin e instrumenteve vlerësues. Kështu, sipas të dhënave shohim se një përqindje e lartë e mësuesve e respektivisht 72% e tyre bazohen gjithmonë mbi artikujt që masin kompetencën gramatikore e ndërkohë 20% e bëjnë këtë gjë shpesh. Përsa i takon peshës që aspekti leksikor zë në vlerësim shohim se edhe ky element zë një vend të rëndësishëm.

Kështu 57% e mësuesve janë shprehur se ata bazohen gjithmonë mbi këta elementë, 23% shpesh dhe 20% ndonjëherë. Aftësia e të lexuarit ka një shpërndarje disi më të çrregullt mes mësuesve teksa shohim që 17% e përdorin rrallë, 52% ndonjëherë, 26% shpesh dhe 5% gjithmonë. Nga ana tjetër të shkruarit është një aftësi që merr një përqindje të lartë pikësh.

Mësuesit e anketuar janë përgjigjur se ata bazohen shpesh në këtë aftësi (58%) e ndërkohë 39% bazohen gjithnjë në të shkruar kurdoherë që hartojnë instrumente vlerësues dhe vetëm 3% e bëjnë këtë gjë ndonjëherë. Aftësia e të dëgjuarit dhe gjatë anketimit na shpërfaqet krejt e veçuar dhe madje e izoluar nga aftësitë e tjera. Të dëgjuarit për 97% të mësuesve tanë është një aftësi që nuk përfshihet kurrë në vlerësim. Dhe vetëm 2 mësues janë përgjigjur se e përfshijnë atë rrallëherë në vlerësimet e tyre.

Këto shifra tregojnë për një ndarje pothuajse të plotë të aftësisë së të dëgjuarit nga aftësitë e tjera njësoj si të ishte një aftësi dytësore dhe e parëndësishme. Pavarësisht arsyeve të ndryshme që mësuesit mund të kenë në zbatimin e ushtrimeve të kësaj natyre, është e pafalshme që nxënësit të mos vlerësohen për këtë aftësi – në fund të ditës ata nuk do të mund të komunikojnë në këtë gjuhë të huaj nëse ata nuk aftësohen dhe natyrshëm nuk vlerësohen për zbatimin e kësaj njohurie që në klasë. Të folurit na paraqitet me një shpërndarje të çrregullt mes mësuesve.

Ata duken të kenë mendime të ndryshme në lidhje me rolin e kësaj aftësie në vlerësim. Kështu shohim se 41% prej tyre bazohen ndonjëherë në këtë aftësi, pasuar nga 28% prej tyre që bazohen rrallë. Shohim se janë të paktë ata mësues që i japin një peshë të rëndësishme kësaj aftësie pasi në anketimin tonë rezultoi se 13 mësues e përdorin atë shpesh dhe vetëm 4 mësues e përdorin atë gjithmonë në vlerësim.

Ndërkohë befasues është fakti se 95% e mësuesve nuk u kërkonin kurrë këshilla kolegëve të tyre në lidhje me vlefshmërinë dhe besueshmërinë e artikujve vlerësues që ata hartonin. Po kaq interesante është të shohim ndarjen e përqindjeve në

përgjigje në lidhje me fokusin e vlerësimit: disa mësues përqëndroheshin tek përparimi i nxënësve në mënyrë individuale dhe disa të tjerë përqëndroheshin në krahasimin e nxënësve apo dhe klasave.

Është pozitive të përmendet se shumica e mësuesve i njoftonin paraprakisht shumë shpesh nxënësit e tyre në lidhje me vlerësimin për t'u dhënë atyre kohë që të përgatiteshin përpara zbatimit të instrumentit vlerësues. Ajo çfarë mund të lexohet nga tabela e mësipërme është se jo të gjithë mësuesit kanë të njëjtat parime e principe në lidhje me hartimin e instrumentave vlerësues. Është e dukshme që zgjedhjet për çështjet e mësipërme janë kryesisht zgjedhje individuale e të padiktuara nga institucionet drejtuese apo dhe dokumenta ose udhëzime zyrtare në lidhje me procesin e vlerësimit të të nxënit.

Ky fakt ndoshta është edhe arsyeja bazë përse në klasa me mësues të ndryshëm vërehet një kakovni tipesh vlerësimi si në përmbajtje ashtu edhe në formë. Pasi kemi prezantuar rezultatet e pyetjeve mbi hartimin dhe planifikimin e vlerësimit më poshtë do të vijnë duke dhënë sintezën e rezultateve të mbledhura në lidhje me hapin e dytë, atë të zbatimit të instrumenteve vlerësues në klasë.

Tabela 1.4

Zbatimi	Kurrë		Rrallë		Ndonjëherë		Shpesh		Gjithmonë	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1. I informoj nxënësit mbi arsyet përse ata po vlerësohen.	-	-	-	-	18	33	25	46	11	21
2. U dhëzoi ata në mënyrë të qartë mbi kryerjen e ushtrimeve vlerësuese.	-	-	-	-	-	-	1	1	53	99
3. Nxënësit ndihmohen kur ata kanë një problem i cili i pengon në plotësimin e ushtrimit vlerësues.	-	-	-	-	11	21	16	29	27	50
4. U ofroj nxënësve mundësinë për të monitoruar punën e tyre ndërkohë që ata kryejnë ushtrimet vlerësuese.	-	-	-	-	-	-	42	78	12	22
5. U jap nxënësve komente të menjëhershme pas mbarimit nga ana e tyre të ushtrimeve vlerësuese.	-	-	-	-	-	-	29	54	25	46
6. Nxënësve u jepet mundësia të vlerësojnë veten.	51	94	3	6	-	-	-	-	-	-
7. Nxënësve u jepet mundësia të vlerësojnë nxënësit e tjerë në klasë.	51	94	3	6	-	-	-	-	-	-

Elementi i zbatimit të instrumenteve vlerësues me nxënësit shfaq disa karakteristika të ndryshme me hartimin e tij. Kështu vëmë re lehtësisht se përgjigjet e mësuesve janë pothuajse në të njëjtën drejtim me dallime shumë të lehta mes tyre. Shpërndarja më e zhdrejtë është përse i takon çështjes së informimit të nxënësve mbi arsyet përse ata po vlerësohen. 46 % e mësuesve e bëjnë shpesh këtë gjë, 21% e bën gjithmonë ndërkohë që 33 % prej tyre mendojnë se ky veprim duhet të bëhet ndonjëherë por jo gjithmonë. Nga ana tjetër, dallohet dukshëm se nxënësit udhëzohen gjithmonë nga mësuesit e tyre në lidhje me kryerjen e ushtrimeve.

Po kështu shohim se gjysma e mësuesve të pyetur i ndihmojnë gjithmonë nxënësit e tyre kur ata kanë një problem i cili i pengon në kryerjen e ushtrimit ndërkohë që pjesa e mbetur e mësuesve e bën këtë gjë shpesh ose ndonjëherë. Nxënësve gjithashtu u ofrohen shpesh mundësi për të monitoruar punën e tyre dhe përgjithësisht ata marrin menjëherë komentet përkatëse për kryerjen saktë apo jo të ushtrimeve vlerësuese që sapo kanë përfunduar. Në një mendje janë mësuesit e pyetur edhe në lidhje me dy çështje të tjera: vetëvlerësimin dhe vlerësimin e tjetrit.

Çuditërisht shohim se kemi një numër të njëjtë përgjigjesh për të dyja këto pyetje. 95% e të anketuarve janë përgjigjur se nxënësve nuk u jepet asnjëherë mundësitë për të vlerësuar dhe vetëvlerësuar dhe vetëm 6% prej tyre e bëjnë këtë gjë në raste sporadike.

Tabela 1.5

Rezultatet	Kurrë		Rrallë		Ndonjëherë		Shpesh		Gjithmonë	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
1. Hartoj një sistem notash/pikësh si pjesë e procesit vlerësues	-	-	-	-	-	-	-	-	54	100
2. Hartoj kritere vlerësimi specifike e të detajuara për secilin artikull.	54	100	-	-	-	-	-	-	-	-
3. U jap nxënësve informacion të bollshëm në lidhje me kriteret e vlerësimit.	25	46	29	54	-	-	-	-	-	-
4. Vlerësoj në mënyrë periodike performancën e nxënësve.	-	-	-	-	-	-	35	65	19	35
5. Përdor rezultatet e vlerësimit për të rishikuar mësimdhënien time.	-	-	-	-	21	39	33	61	-	-
6. I përdor rezultatet e vlerësimit pozitivisht dhe jo negativisht.	-	-	-	-	-	-	37	68	17	32
7. E kam bërë vlerësimin pjesë të pandarë të mësimdhënies dhe nxënies.	8	15	29	54	17	31	-	-	-	-
8. I ndaj të dhënat e vlerësimit me mësuesit e tjerë.	51	94	3	6	-	-	-	-	-	-
9. Komentet e përgjithshme mbi vlerësimin i japin mundësi nxënësve që të përmirësojnë punën e tyre dhe të përparojnë në të mësuarit e tyre.	-	-	-	-	-	-	49	90	5	10
10. Procesi i vlerësimit mbështetet nga përfshirja e nxënësve në të.	51	94	3	6	-	-	-	-	-	-

Edhe ky seksion i fundit i pyetësorit shihet se ka rezultuar në përgjigje shumë të përafërta e shpeshherë identike në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e rezultateve të vlerësimit. Ndërkohë që të gjithë mësuesit që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se hartojnë një sistem notash a pikësh si pjesë e sistemit të vlerësimit shohim se nga ana tjetër askush prej tyre nuk harton kritere vlerësimi specifike për secilin artikull vlerësues. 46% prej tyre përgjigjen se nuk u japin kurrë informacion

të bollshëm në lidhje me kriteret e vlerësimit të 54% e bëjnë këtë rrallëherë. Performanca e nxënësve vlerësohet periodikisht shpeshherë nga 68% e mësuesve e gjithmonë nga 32% prej tyre.

Është pozitive të shohim se mësuesit e përdorin vlerësimin për të rishikuar problematikat e mundshme në mësimdhënien e tyre dhe ky është një hap përpara në këtë drejtim dhe shpeshherë ata i përdorin rezultatet e vlerësimit pozitivisht. Ata gjithashtu mendojnë se komentet e përgjithshme mbi vlerësimin i japin mundësi nxënësve që të përmirësojnë punën e tyre dhe të përparojnë në të mësuarit e tyre. Në këtë prizëm shihet se nxënësit e shohin vlerësimin si një hap të mëtejshëm drejt një nxënieje më të suksesshme.

Ndërkohë, me keqardhje vëmë re se të anketuarit deklarojnë që vlerësimi nuk është pjesë e pandarë e mësimdhënies së tyre. Vetëm 17 prej tyre e shohin si të tillë ndonjëherë ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre rrallëherë e shohin vlerësimin të lidhur me mësimdhënien e mësimnxënien. Në një hije negativiteti qëndron dhe ndarja e të dhënave të vlerësimit me mësuesit e tjerë. 94% e mësuesve u përgjigjen që nuk e bënin kurrë një veprim të tillë.

Ata gjithashtu ritheksojnë se procesi i vlerësimit nuk mbështetet nga përfshirja e nxënësve në të. Siç vërehet dhe nga përgjigjet e mbledhura vlerësimi në mësimdhënien e gjuhëve të huaja përbën një hallkë problematike në zinxhirin e sistemit arsimor. Është mjaft e nevojshme që fillimisht të hartohen dhe unifikohen disa kriteret e vlerësimit për nxënësit në mënyrë që si mësuesi ashtu edhe nxënësi të jenë të qartë mbi vlerësimin e kryer. Po kaq e nevojshme është që të ofrohen trajnime në fushën e vlerësimit në mënyrë që të gjithë mësuesit të jenë të mirëinformuar mbi këtë element kyç në mësimdhënien dhe që të gjithë t'i masin nxënësit e tyre duke përdorur të njëjtin 'kut'.

Pesha që vlerësimi zë në procesin mësimor duhet të pranojmë se në realitet nuk është në nivelet e duhura dhe për më tepër ky aspekt nuk shihet i lidhur drejtpërsëdrejti me procesin e mësimdhënies e mësimnxënies por shumë mësimdhënës e shohin atë si një zgjatim të këtij procesi dhe si një barrë e cila hera herës duhet mbajtur në kurriz prej tyre e hera herës duhet lënë mënjanë. Informacioni i marrë nga vlerësimet sporadike të mësuesve nuk përdoret për të sjellë përmirësime në procesin mësimor apo për të ndrequr gabimet e mundshme të mësuesve gjatë mësimdhënies.

Krejtësisht ndryshe, ky proces shihet si i njëkrahshëm ku nxënësit vihen në provën e zjarrit dhe për çfarëdolloj dëmtimi apo rezultati të dobët faktorë në këtë mes janë vetëm ata: nxënësit. Duke qenë se panorama që na shpërfaqet është disi tepër e zymtë, atëherë është akoma më e fortë dhe e menjëhershme nevoja për të ndërhyrë në elementët e vlerësimit të të nxënësve dhe për ta shndërruar këtë element në bërthamën e orës së mësimin ku vlerësimi të lidhet drejtpërsëdrejti me shpjegimin e rradhës dhe me ndaljen në problemet që janë evidentuar prej tij.

## Literatura

1. Alderson, J.C., & Banerjee, J. (2002). Language testing and assessment (Part 2). *Language teaching*.
2. Coombe, C., Folse, K. & Hubley, N (2007). A practical guide to assessing English language learners. Ann Arbor, MI: University of Michigan Press.
3. Day, R. R. (1990) Teacher observation in second language teacher education. In Richards, J. C. and Nunan, D. (Eds.), *Second Language*.
4. Harmer, J. 2007, "The Practice of English Language Teaching" Pearson, Longman.